

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

lidhur me ecurinë e gjykimit të çështjes nr.20 Akti, datë 15.05.2023, seanca gjyqësore e të cilës u zhvilluar në mungesë të palës paditëse:

VËREN

- 1.** Paditësi Armando Subashi, kryetar i Bashkisë Fier i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “*Shfuqizimin e vendimit (pa numër) datë 08.05.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, KQZ-së.*”.
- 2.** Nga aktet e dosjes rezulton se më datë 15.05.2023 pala paditëse ka paraqitur kërkesë padinë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nëpërmjet shërbimit postar (dorëzuar në postë më datë 12.05.2023, marrë dijeni më datë 08.05.2023), brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor.
- 3.** Kërkesë padia rezulton të jetë paraqitur në respektim të plotë të formës dhe të paraqitjes së saj, kritere këto të përcaktuara në nenin 153 të Kodit Zgjedhor. Sipas vendim për plotësim të të metave të padisë, ka rezultuar se me shkresën nr. 4151/2 prot., datës 18.05.2023, depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit më datë 18.05.2023 me lëndë: *Kërkesë për plotësimin e të metave të kërkesë padisë*, paditësi ka sjellë në cilësinë e provës shkresën nr. 4151/1 prot., datë 17.05.2023 me lëndë: Informacion të Zyrës së Shtypit si dhe faqe të njoftimeve elektronike të adresës zyrtare Facebook të Bashkisë Fier dhe të faqes zyrtare të Facebook të Kryetarit të Bashkisë Fier Armando Subashi, bashkëlidhur 13 fletë kopje të faqeve të njoftimeve elektronike të adresës zyrtare Facebook të Bashkisë Fier dhe të faqes zyrtare të Facebook të Kryetarit të Bashkisë Fier z. Armando Subashi.
- 4.** Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

5. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Pala paditëse, kryetari aktual z. Armando Subashi i Bashkisë Fier (njëkohësisht kandidatit për kryetar në bashkinë Fier)¹ është subjekt zgjedhor i regjistruar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

6. Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ka paraqitur para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (shkurt KRIIK) denoncimin/raportin për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale, nga 20 (njëzet) bashki dhe 1 (një) një kryetar bashkie, për të cilat pretendohet se kanë bërë postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive respektive, të cilat përbëjnë përdorim të burimeve publike (Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të

¹ Krijuar me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse (neni 1) dhe çdo bashki ka kryetarin e saj, të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor (neni 59)

administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 24 Prill 2023, “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14 Prill- 20 Prill 2023”). Në vijim pretendohet se: *Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 13 Janar 2023, ashtu si dhe më parë, e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Bashkive të vendit janë përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#)” e konkretisht për rastin në fjalë: (nr. 5. Bashkia Fier - Kryetar Armando Subashi Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier është përdorur hashtag #ShqipëriaEardhmjaJonë; #SkaKohëPërPushim.*

7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 441, datë 05.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 349 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj kryetarit të bashkisë Belsh, Bulqizë, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Poliçan, Prrenjas, Pustec, Roskovec, Shijak dhe Vorë për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 ka vendosur:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për:

- ..

- Z. Armando Subashi, kryetar për bashkinë Fier;

...

4. Urdhëroj fshirjen e menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të secilës Bashki, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.

5. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

8. Në këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndër të tjera ka arsyetuar: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje

elektorale, nga 20 (njëzet) bashki dhe 1 (një) kryetar bashkie, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive, përbëjnë përdorim të burimeve publike.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 24 Prill 2023, “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14 Prill- 20 Prill 2023”.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin

e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Denoncuesi nëpërmjet denoncimit pretendon si vijon:

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 13 Janar 2023, ashtu si dhe më parë, e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Bashkive të vendit janë përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#)”.

Tipikisht janë përdorur sloganet:

Të bashkuar, jo të ndarë;

Shqipëria e ardhmja jonë; dhe

S’ka kohë për pushim.

Dy prej këtyre sloganeve janë përdorur fillimisht prej Partisë Socialiste si slogane elektorale gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, e në vazhdim, ndërsa i treti si slogan i Partisë Socialiste prej Marsit 2022.

Konkretisht:

1. Slogani “SkaKohëPërPushim”, ka qenë zyrtarisht slogani i fushatës elektorale të Partisë Socialiste gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021. Kryetari i PS dhe kryeministri i vendit z. Rama, është shprehur para zgjedhjeve të vitit 2021 se “Programi i PS-së do të jetë ishtrirë në kohë, për një Shqipëri të vitit 2030 ndërsa slogani është: “S’ka kohë për pushim”.

2. Slogani “Shqipëria, e ardhmja jonë” është përdorur gjithashtu gjatë fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 në të gjithë materialet propagandistike të Partisë Socialiste.

Për më shumë shihni link-un: “Shqipëria, e ardhmja jonë”/ Publikohet slogani i PS-së në zgjedhjet e 25 prillit”).

3. Slogani “Të bashkuar, jo të ndarë” është slogani i përdorur nga Partia Socialiste në Kongresin e saj të Prillit 2022, si një slogan i cili do të përdoret më pas në mënyrë të vazhdueshme nga Kryeministri Rama dhe në aktivitetet zyrtare të Partisë Socialiste dhe përfaqësuesve të saj.

Për më shumë shihni link-et: - “Të bashkuar, jo të ndarë!”/ Rama prezanton ‘sloganin’ e ri, “kunjë” për PD?”; - “Rama ndan foton nga Kongresi i PS dhe ka një mesazh: T’i lëmë pas hendeqet politike, të bashkuar dhe jo të ndarë si shqiptarë”; “Të bashkuar, jo të ndarë”, PS mbledh Asamblenë Kombëtare. Gjikhuri: Qëndrimi gjatë në pushtet ka risqet. Garën e kemi me veten”.

Dy sloganet e para janë shpallur publikisht dhe përdorur nga Partia Socialiste si slogane të fushatës elektorale në zgjedhjet e vitit 2021 e në vazhdim, përfshi zgjedhjet e pjesshme të 6 Marsit 2022, ndërsa i treti lidhet drejtpërdrejt me Partinë Socialiste e vazhdon e përdoret në mënyrë të vazhdueshme prej përfaqësuesve të saj. Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive:

1..

...

5. Bashkia Fier - Kryetar Armando Subashi

Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier është përdorur hashtag

#ShqipëriaEArdhmjaJonë; #SkaKohëPërPushim...

Pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të bashkive subjekt i këtij denoncimi, janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale.

Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj se faqet e rrjetit social "Facebook", me emrin bashkive objekt denoncimi, janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve.

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1, parashikon se "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia". Po ky nen parashikon se "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në "facebook" apo çdo mjete tjetër elektornik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Në kushtet ku nga bashkitë Belsh, Bulqizë, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Prrenjas, Pustec, Roskovec, Shijak, objekt denoncimi, janë bërë një sërë publikimesh të cilat përmbajnë hashtag # dhe slogane me karakter politik/elektoral, duke keqpërdorur, këto llogari institucionale që përbëjnë burim publik, vlerësohet se jemi përpara një shkelje administrative të Kodit Zgjedhor, pasi vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023.

Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në facebook të kryetarit të bashkisë, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore siç janë liria për t'u shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. ...

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rastet objekt denoncimi të regjistruar me nr. 349 ID, për pikat nga 1- 15 dhe 17-20 përbëjnë shkelje të nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe duhet të fshihen menjëherë nga faqja e tyre e rrjetit social.

Për rrjedhojë, referuar nenit nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë

9. Kundër këtij vendimi të mësipërm, paditësi, nuk ka paraqitur kërkesë ankimore në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).

10. Në vijim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj kryetarëve të bashkisë Belsh, bashkisë Bulqizë, bashkisë Cërrik, bashkisë Fier, bashkisë Elbasan, bashkisë Gramsh, bashkisë Kavajë, bashkisë Këlcyrë, bashkisë Kolonjë, bashkisë Konispol, bashkisë Kukës, bashkisë Lezhë, bashkisë Librazhd, bashkisë Lushnje, bashkisë Mallakastër, bashkisë Prrenjas, bashkisë Pustec, bashkisë Roskovec, si dhe bashkisë Shijak në masën 3 000 (tre mijë) lekë, duke e mbështetur këtë propozim në nenin 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor, ku është edhe pala paditëse.

11. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, në përfundim të hetimit administrativ ka disponuar me vendimin nr. 84 datë 08.05.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21,

datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve” bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka vendosur:

1. *Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

2. *Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, bazuar në nenin 172, pikën 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, në cilësinë e subjektit zgjedhor ndaj:*

- z.

...

- z. Armando Subashi, kryetar në bashkinë Fier;

...

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

12. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera në vendimmarrjen e tij ka arsyetuar se:

1. Kërkesa e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj 19 kryetarëve të bashkive të sipërcituara, bazuar në denoncimin me nr. 349 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ka si shkak postimet në faqet zyrtare “Facebook” të bashkive të drejtuara nga ata, të cilat janë përdorur për të publikuar postime me përmbajtje hashtag (#), sloganesh apo thirrjesh të karakterit elektoral/politik, duke promovuar kështu subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

2. Faqet zyrtare të institucioneve publike në rrjetet e ndryshme sociale (facebook, tëiter, instagram etj.) bëjnë pjesë në kategorinë “asete”, në kuptim të pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pra ato janë “burime” të institucionit në kuptim të kësaj dispozite. Kjo do të thotë se faqet zyrtare të bashkive në rrjetet e ndryshme sociale të sipërcituara, nuk mund të përdoren ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

3. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se “...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”. Ky ndalim është konfirmuar edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, i cili në përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara” ndalonon “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për qëllime zgjedhore”.

4. Ndërkohë, pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, në të cilën Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve është bazuar në propozimin e masës administrative ndaj personave përgjegjës, përcakton sanksionin për shkeljet e kryera “nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi”. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucioneve të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të

administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhërave për listat dhe zonat e qendrave të votimit) etj. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor. Titullari i institucionit apo entit që ka në administrim aset publik nuk bën pjesë në listën e “personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit”. Për këtë arsye, KAS çmon se ankioni për të nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

5. Për keqpërdorimin e burimeve publike Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi edhe subjektet zgjedhore përfituese. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se “subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetshëm, si dhe për shkak se postimet e aksesueshme në facebook bëjnë fjalë për veprimtari elektorale të tyre dhe jo të subjektit që e mbështet, atëherë për këto shkelje duhen trajtuar subjekt zgjedhor përfitues, kandidatët dhe jo partia politike që i mbështet ato.

6. Kandidatët për kryetar bashkie objekt i këtij procedimi administrativ, kanë qenë në dijeni të publikimit të sloganeve politico-elektorale në faqet zyrtare të rrjeteve sociale të bashkive të tyre. Publikimet në fjalë kanë qartësisht si qëllim sensibilizimin politik të publikut. Në kushtet kur ata gëzojnë cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidatë për kryetar bashkie, është e qartë se publikimet në shkelje të ndalimeve në Kodin Zgjedhor, janë kryer në favor të tyre. Në këto rrethana ata kanë pasur detyrimin për ndërprerjen e menjëhershme të shkeljes, gjë që nuk ka ndodhur.

7. Përgjegjësia për vendosjen në përdorim apo në mbështetje të kandidatëve apo të subjekteve zgjedhore të faqeve zyrtare të institucioneve publike është e kryetarit të bashkisë. Këtë e saktëson vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, nëpërmjet shkronjave “a” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 7. Gjithësesi, KAS-i konstaton se KQZ-ja nuk ka sensibilizuar në kohë publikisht, sikurse nuk ka paralajmëruar institucionet për largimin nga praktika e vjetër e përdorimit politik të faqeve të institucioneve në rrjetet sociale.

8. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se “subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”. Kjo do të thotë se hetimi administrativ për keqpërdorimin e burimeve publike duhet të shoqërohet në çdo rast edhe me hetimin për rolin e subjektit zgjedhor përfitues nga veprimtaria. Në përfundim të hetimit administrativ si Komisioneri, ashtu dhe KAS-i duhet të mbajnë qëndrim dhe vlerësim të shprehur për këtë rol.

9. Kandidatët për kryetar bashkie të ngarkuar me përgjegjësi sipas vendimit nr. 441, datë 05.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, gëzojnë statutë dyfishtë, si kandidatë dhe si kryetarë në detyrë të bashkive përkatëse. Si kryetar të bashkive, personat në fjalë kanë akses, dijeni dhe përgjegjësi për postimet në faqen zyrtare të bashkive që ato drejtojnë. Ato kanë të gjithë pushtetin e nevojshëm ligjor për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljes së ligjit dhe për të marrë masa që kjo sjellje të mos përsëritet. Fakti që ata nuk e kanë ushtruar këtë pushtet

deri ditën e urdhërimit nga Komisioneri do të thotë se ata duhet t'i nënshtrohen, në cilësinë e subjektit zgjedhor, veprimet të sanksionit të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

10. Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, KAS-i çmon se kryetarët e bashkive, në cilësinë e tyre si kandidatë për kryetar bashkie, si subjekte zgjedhor përfitues nga keqpërdorimi i faqeve zyrtare të institucionit në rrjetin social facebook, duhet të mbahet përgjegjës për shkelje të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

11. Nuk mund të bëhet i njëjti arsyetim për subjektin zgjedhor "Partia Socialiste" që mbështet kandidatët në fjalë. Gjatë shqyrtimit të kërkesës në KAS, si përfaqësuesit e administratës, po ashtu dhe nuk sollën prova për të vërtetuar faktin nëse Partia Socialiste ka qenë apo jo në dijeni të zhvillimit të këtyre aktiviteteve në kushtet e ndalimit nga Kodi Zgjedhor.

12. Ndërkohë, përse i përket caktimit të masës së sanksionit, KAS-i çmon se duhet t'i japë peshën që i takon faktit se ende nuk ka perceptim të qartë ndër aktorët se përdorimi i adresës zyrtare të institucionit në facebook dhe rrjetet e tjera sociale për fushatë elektorale përbën keqpërdorim të burimeve publike.

13. Ndëshkimi administrativ nuk është qëllim primar i Kodit Zgjedhor. Përpara tij vjen informimi, edukimi, paralajmërimi. Përshkak se këto mundësi KQZ-ja nuk i ka vënë në shfrytëzim për këtë tipologji shkeljesh, KAS-i vlerëson se nuk duhet të sanksionohen në kuptim të pikës 2 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor për z. Lefter Alla, kryetar në bashkinë Bulqizë; z. Klodian Taçe, kryetar në bashkinë Gramsh; z. Shuaip Beqiri, kryetar në bashkinë Konispol; z. Kastriot Gurra, kryetar në bashkinë Librazhd, të cilët nuk rikandidojnë më për ato poste.

14. Në lidhje me të drejtën e ankimit, sa i përket personave të sanksionuar, duke qenë se ata janë dënuar administrativisht në cilësinë e subjektit zgjedhor, në zbatim të nenit 145 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se "Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi", ata mund ta ushtrojë të drejtën e ankimit pikërisht duke ju drejtuar Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Duke qenë se ky vendim është marrë në periudhën e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit për zgjedhje, atëherë ankimi bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Ky qëndrim mbështetet dhe në praktikën e Kolegjit Zgjedhor që e ka pranuar kompetencën për shqyrtimin e dënimeve administrative ndaj subjekteve zgjedhore, më konkretisht në vendimin nr. 3, datë 09.03.2023.

12.1 Mendim paralel i dy anëtarëve të KAS:

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj kryetarëve të disa bashkive, në anëtarët Elvin Lako dhe Koli Bele, duke mos qenë dakord me masën e sanksionit administrativ, si dhe argumentet e parashtruara nga anëtarët e tjerë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), jemi të mendimit se KAS nuk duhet të sanksiononte kryetarët e bashkive me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë, në bazë të nenit 172, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", për arsye e mëposhtme.

2. Kodi Zgjedhor kërkon plotësimin e dy kushteve kumulative për aplikimin e nenit 172, pika 1: i. Subjektet zgjedhore të kenë marrë dijeni se në favor të tyre

janë kryer shkelje të ndalimeve të përcaktuara në Kod; ii. Pas marrjes dijani, nuk kanë marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes.

3. Hetimi administrativ përpara KSHZ si dhe KAS, nuk arriti të provojë marrjen dijani nga ana e subjektit elektoral (kryetarët e bashkive) të shkeljes objekt hetimi, por në çdo rast edhe nëse do pranohej argumenti i anëtarëve të tjerë, se si persona përgjegjës ata janë në dijani për shkak të detyres së tyre, do duhej të hetohej dhe provohej mos marja e “masave të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”. Për më tepër, nga një sondim i faqeve zyrtare të rrjetit “facebook” të bashkive subjekt i këtij vendimi, rezultoi se në shumicën e rasteve postimet me karakter elektoral janë fshirë nga personat përgjegjës. Ky fakt edhe pse i pahetuar administrativisht, gjithsesi krijon bindjen se pas marrjes dijani të shkeljes, subjekti ka marrë masa për ndërprerjen e saj. Rrjedhimisht, duke qenë se dy kushtet kumulative nuk plotësohen, si dhe në rastet e verifikuara nga dy anëtarët e pakicës, rezultoi se shkelja është ndërprerë pas marrjes dijani, nuk mund të aplikohet neni 172, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

4. Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 3.000 (tre mijë) lekë referuar nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Referuar vendimit nr. 45, datë 04.04.2023 të KAS, pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor përcakton sanksionin për shkeljet e kryera “nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga PERSONA TË NGARKUAR ME DETYRA, sipas këtij Kodi”. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucionesh të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor.

5. Përfundimisht, në vlerësojmë se kryetarët për të cilët KAS ka vendosur sanksion administrativ, gjenden në shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, për aq kohë sa kanë publikuar postime me përmbajtje elektorale/politike në faqet e tyre zyrtare” Facebook”, por, duke qenë se kryetari i bashkisë nuk bën pjesë në rrethin e personave të ngarkuara me detyra nga Kodi Zgjedhor, kryetarët në fjalë duhen sanksionuar me masë administrative sipas nenit 171, pika 2 “Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjorbë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.”

13. Subjekti zgjedhor, pala paditëse, pasi është bërë me dije me vendimin e KAS, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se:

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 441 datë 05.05.2023, ka vendosur: Të propozojë marrjen e masës administrative gjorbë në masën 3 000 (tre mijë) lekë në emrin Armando Subashi me cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Fier, për shkak të postimit në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier në formën e hashtag -eve (#) të sloganëve #ShqipëriaEArdhmjaJonë; #SkaKohëPërPushim.

Ky komision mbi bazën e denoncimit nr.349 ID të Koalicionit Për Reformë Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) dhe të dhënave, provave link

dhe materialeve fotografike të pasqyruara në raportin e KRIIK të datës 24.04.2023 “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14.04.2023 - 20.04.2023, ka filluar shqyrtimin e çështjes duke vlerësuar se ka një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

- Lidhur me këtë denoncim nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk është kërkuar informacion në lidhje me postimet në faqen e Facebook të Kryetarit të Bashkisë Fier si dhe në vijim të hetimit administrativ nuk është ftuar si palë në proces për të marr pjesë në seancë dëgjimore.
- Komisioni ka paragjykuar në vendimarrje pa dëgjuar paraprakisht sqarimet, verifikimi i të cilave mund të sillte prova te mjaftueshme për një hetim të plotë jo të njëanshëm të hetimit të nisur nga ky Komision- mungesën e shkeljes administrative.

Postimet në llogaritë personale në Facebook të Kryetarit të Bashkisë nuk janë shkak për propozimin për marrjen e masës administrative, nisur nga fakti se kryetari i Bashkisë është organ me karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim i arritjeve politike ose çdo lloj platforme tjetër politike për tërheqjen e elektoratit.

- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund t’ju referohet ose të trajtojë marrëdhëniet personale ose postimet personale në Facebook, nga Kryetari i Bashkisë të cilat dalin jashtë fushës së zbatimit të Kodit Zgjedhor dhe Akteve normative në fuqi, mbi bazën e të cilave është propozuar për dënimin me gjobë.
- Parashikimi i ndalimeve përsa i përket postimeve në adresën personale interferon në liritë themelore siç është liria për tu shprehur dhe liritë dhe të drejtat politike, për pasojë propozimi për vendosjen e gjobës të vendosur me vendimin nr. 441 datë 05.05.2023 i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimi datë 08.05.2023 i Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili ka pranuar pjesërisht kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur sanksionin administrativ, gjobë në masën 100 000 lekë për Kryetarin e Bashkisë Fier z. Armando Subashi. Për rrjedhojë vendimi (pa numër) datë 08.05.2023 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve , pranë Komisionit Qëndror Zgjedhor ka ardhur si pasojë e një keqinterpretimi të fakteve dhe rrethanave duke çuar në një vendimarrje të gabuar dhe në kundërshtim me ligjin.
- Përsa më sipër, vendimi i datës 08.05.2023 i KAS-it për gjobitjen e paditësit/z.Armando Subashit si Kryetar i Bashkisë Fier është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat proceduriale te Kodit Zgjedhor si dhe Vendimet e Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përfundimisht kërkohet pranimi i kërkesës padisë sipas objektit të saj duke vendosur shfuqizimin tërësisht të vendimit (pa numër), datë 08.05.2023 të KAS-it dhe pushimi i procedimit administrati në emrin e paditësit/ z.Armando Subashi si Kryetar i Bashkisë Fier.
- Me shkresën nr. 4151/2 prot., datës 18.05.2023, depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit më datë 18.05.2023 me lëndë: Kërkesë për plotësimin e të metave të kërkesës padisë, paditësi ka pretenduar se:
 - Paditësi, Armando Subashi me detyrë Kryetar i Bashkisë Fier, pasi mori dijeni për aktet administrative të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, të cilat janë njoftuar jo konform rregullave proceduriale për mënyrën e njoftimit, pasi janë publikuar në faqet zyrtare të KShZ dhe KAS përtej afatit të përcaktuar në ligj për ankimimin e tyre, i është

drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor brenda afatit ligjor 5 ditor, të përcaktuar në nenin 152 të ligjit nr. 10019 dt. 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i R.Sh” të ndryshuar, duke pasqyruar dhe analizuar se veprimet e ndjekura dhe praktikat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, janë në shkelje të hapur të normave proceduriale të parshikuara nga dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor dhe vendimeve të Komisionit Rregullator pranë K.Q.Z -së.

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pranë K.Q.Z -së, me vendimin nr. 441 datë 05.05.2023, ka propozuar marrjen e masës administrative gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë në emrin e paditësit Armando Subashi, si Kryetar i Bashkisë Fier, për shkak të postimit në faqen personale në Facebook në formën e hashtag-eve (#) të sloganëve #ShqipëriaEArdhmjaJonë; #SkaKohëPërPushim.

Ky komision mbi bazën e denoncimit dhe të dhënave, provave link dhe materialeve fotografike të pasqyruara në raportin e KRIIK të dt. 24.04.2023 “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14.04.2023 - 20.04.2023, ka filluar shqyrtimin e çështjes duke vlerësuar se ka një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimin administrativ.

-Lidhur me këtë denoncim nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk është kërkuar informacion në lidhje me postimet në faqen personale të paditësit në Facebook si Kryetar i Bashkisë Fier dhe të Bashkisë Fier si dhe në vijim të hetimit administrativ nuk është ftuar as si palë në proces për të marr pjesë në seancë dëgjimore.

-Në nenin 172/1 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se subjektet elektorale, konkretisht Kryetarët e Bashkive, duhet të kenë marrë dijeni se janë kryer shkelje të ndalimeve të përcaktuara në kod dhe të marrin masa për ndërprerjen e shkeljes.

Komisioni ka paragjykuar në vendimmarrje, nuk ka kryer hetim administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike, për të cilat nga pala denoncuese pretendohet se janë kryer shkelje administrative, pa dëgjuar paraprakisht sqarimet, verifikimi i të cilave mund të sillte prova të mjaftueshme për mungesën e shkeljes administrative.

-Referuar denoncimit, paditësi bën me dije se përsa i përket faqes Facebook Armando Subashi, <https://www.facebook.com/armandosubashi.al>, ajo është një profil i një personi publik, që pavarësisht me pozicionin Kryetar Bashkie, në këto zgjedhje është një kandidat i një subjekti zgjedhor të rregjistruar në KQZ dhe që ligjërisht humbiste të drejtën e kompetencave të plota në institucionin e Bashkisë për të cilën është një nga kandidatët për drejtimin e saj në 4 vitet e ardhshme, referuar dispozitave të K.Zgjedhor.

Postimet e tij në llogarinë personale në Facebook si Kryetar i Bashkisë nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për propozimin për marrjen e masës administrative, nisur nga fakti se Kryetari i Bashkisë është organ me karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim i arritjeve politike ose çdo lloj platforme tjetër politike për tërheqjen e elektoratit.

-Gjithashtu paditësi bën me dije se për faqen e Bashkisë Fier në rrjetin social Facebook, jo vetëm përgjatë kësaj fushate por në asnjë moment nuk janë publikuar deklarata, lajme, informacione dhe as janë përdorur simbole që lidhen me politikën apo fushatën zgjedhore. Në faqen zyrtare të Facebook të Bashkisë Fier nuk janë përdorur hashtag/slogane me karakter politik ose elektorale në

zgjedhje ose thirrje për mbështetje politike, të cilat do të përbënin përdorim të burimeve publike.

Duke ju referuar objektit të denoncimit, simboli # nuk është përdorur në asnjë moment dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme, pasi ajo është një faqe publike që mund të shihet nga të gjithë. Faqja zyrtare e Bashkisë Fier në rrjetin social Facebook është <https://www.facebook.com/bashkia.efierit>. Edhe në faqen zyrtare Ëeb të Bashkisë Fier nuk është pasqyruar asnjëherë asnjë deklaratë, informacion, lajm ose promovim që lidhet me fushatën zgjedhore të Kryetarit të Bashkisë dhe as me politikën.

-Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund t'ju referohet ose të trajtojë marrëdhëniet personale ose postimet personale në Facebook, të cilat dalin jashtë fushës së zbatimit të Kodit Zgjedhor dhe Akteve normative në fuqi, mbi bazën e të cilave është propozuar për dënimin me gjobë.

Propozimi për vendosjen e gjobës të vendosur me vendimin nr. 441 dt. 05.05.2023 i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimi nr. 84, dt. 08.05.2023 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili ka pranuar pjesërisht kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur sanksionin administrativ, gjobë në masën 100 000 lekë për z. Armando Subashi si Kryetar i Bashkisë Fier, duhet të shfuqizohet pasi paditësi pretendon se nuk gjendet në shkelje të dispozitave të K.Zgjedhor duke publikuar postime me përmbajtje politike në faqen zyrtare "Facebook" të Kryetarit të Bashkisë.

-Përsa më sipër, vendimet për gjobitjen e tij si Kryetar i Bashkisë Fier, janë veprime të kryera në kundërshtim me ligjin dhe rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimet e Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendor të Zgjedhjeve dhe për këto arsye kërkon shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 84 dt. 08.05.2023 të KAS dhe pushimin e procedimit administrativ në emër të Kryetarit të Bashkisë Fier.

Si prova paditësi paraqet: shkresën nr. 4151/1 prot., datë 17.05.2023 me lëndë: Informacion të Zyrës së Shtypit si dhe faqe të njoftimeve elektronike të adresës zyrtare Facebook të Bashkisë Fier dhe të faqes zyrtare të Facebook të Kryetarit të Bashkisë Fier Armando Subashi, ku sqarohet se:

Bashkia Fier disponon dy mënyra për publikimin e aktivitetit të saj: Ëeb- i cili është ndërtuar së fundmi pas hakerimit që iu bë në fundvitin e 2022 dhe FB me emrin Bashkia Fier.

Në faqen zyrtare ËEB të Bashkisë Fier nuk është pasqyruar asnjëherë asnjë deklaratë, informacion, lajm apo promo që lidhet me fushatën zgjedhore të Kryetarit të Bashkisë dhe as me politikën.

E njëjta gjë vlen edhe për faqen bashkisë Fier, në rrjetin social Facebook. Jo vetëm përgjatë kësaj fushate, por në asnjë moment nuk janë publikuar deklaratat, lajme, informacione dhe as janë përdorur simbole që lidhen me politikën apo fushatën zgjedhore.

Duke iu referuar objektit të denoncimit, simboli # nuk është përdorur në asnjë moment dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme, pasi ajo është një faqe publike që mund të shihet nga të gjithë. Faqja zyrtare e Bashkisë Fier në rrjetin social FB është <https://www.facebook.com/bashkia.efierit>. Përsa i përket faqes facebook Armando Subashi, <https://www.facebook.com/armandosubashi.al>, ajo është një profil i një personi publik, që pavarësisht me pozicionin Kryetar Bashkie, në këto zgjedhje ishte një kandidat i një subjekti zgjedhor të regjistruar në KQZ dhe që ligjërisht humbet të drejtën e kompetencave të plota në institucionin e Bashkisë për të cilin është një nga kandidatët për drejtimin e tij në 4 vitet e

ardhshme, referuar dispozitave të kodit zgjedhor. [*Bashkëngjitur 13 (trembëdhjetë) kopje të faqeve të njoftimeve elektronike të adresës zyrtare Facebook të Bashkisë Fier dhe të faqes zyrtare të Facebook të Kryetarit të Bashkisë Fier z. Armando Subashi*]

14. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit prapësoi se:

- Si në vendimin e Komisionerit, ashtu dhe të KAS-it, është konstatuar shkelja administrative, duke vënë në dispozicion faqen zyrtare në "facebook" apo çdo mjeti tjetër elektronik (media sociale) të institucionit publik për publikimin e postimeve me përmbajtje hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e institucioneve publike, përbën përdorim të burimeve publike, sipas pikës 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, bazuar edhe në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.
- Lidhur me masën administrative të caktuar, KAS-i çmon se përgjegjësia për vendosjen në përdorim apo në mbështetje të kandidatëve apo të subjekteve zgjedhore të faqeve zyrtare të institucioneve publike është e kryetarit të bashkisë. Kryetari i bashkisë Fier z. Armando Subashi gëzon status të dyfishtë, pasi ai rikandidon në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Si kryetar bashkie, ka akses, dijeni dhe përgjegjësi për postimet në faqen zyrtare të bashkisë që drejton. Ai ka të gjithë pushtetin e nevojshëm ligjor për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljes së ligjit dhe për të marrë masa që kjo sjellje të mos përsëritet. Fakti që z.Armando Subashi nuk e ka ushtruar këtë pushtet deri ditën e urdhërimit nga Komisioneri, do të thotë se ai duhet t'i nënshtrohet, në cilësinë e subjektit zgjedhor, veprimit të sanksionit të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor.
- Në konkluzion, duke marrë parasysh se kryetari i bashkisë, në cilësinë e tij si kandidat për kryetar bashkie, ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga keqpërdorimi i faqes zyrtare të institucionit në rrjetin social "facebook", duhet të mbahet përgjegjës për shkelje të parashikuar nga pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Në kushtet kur kryetari i bashkisë gëzon cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidat për kryetar bashkie, është e qartë se publikimet në shkelje të ndalimeve në Kodin Zgjedhor, janë kryer në favor të tij.
- Referuar vendimit nr.19, datë 15.05.2023, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, ku është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes, pala e paditur kërkon: *rrëzimin e kërkesë padisë të z. Armando Subashi, kryetar i bashkisë Fier, pasi është gjë e gjykuar dhe si e tillë duhet të pushohet*. Për sa më sipër, pala e paditur kërkon: *Rrëzimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi, bashkia Fier, z. Armando Subashi. Lënien në fuqi të vendimit nr. 84, datë 08.05.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve", të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.*

15. Paditësi Armando Subashi, nëpërmjet Shkresës Nr. 4151/2 prot., Dt.18/05/2023, i ka bërë me dije Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, se:

“Unë, Armando Subashi me detyrë Kryetar i Bashkisë Fier, pasi mora dijeni për aktet administrative të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, të cilat janë njoftuar jo konform rregullave procedurale për mënyrën e njoftimit, pasi janë publikuar në faqet zyrtare të KShZ dhe KAS përtej afatit të përcaktuar në ligj për ankimimin e tyre, i jam drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor brenda afatit ligjor 5 ditor, të përcaktuar në nenin 152 të ligjit nr. 10019 dt. 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i R.Sh” të

ndryshuar, duke pasqyruar dhe analizuar se veprimet e ndjekura dhe praktikat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, janë në shkelje të hapur të normave procedurale të parashikuara nga dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor dhe vendimeve të Komisionit Rregullator pranë K.Q.Z -së.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pranë K.Q.Z -së, me vendimin nr. 441 datë 05.05.2023, ka propozuar marrjen e masës administrative gjorbë në masën 3 000 (tre mijë) lekë në emrin tim si Kryetar i Bashkisë Fier, për shkak të postimit në faqen personale në Facebook në formën e hashtag-eve (#) të sloganëve #ShqipëriaEArdhmjaJonë; #SkaKohëPërPushim.

Ky komision mbi bazën e denoncimit dhe të dhënave, provave link dhe materialeve fotografike të pasqyruara në raportin e KRIIK të dt. 24.04.2023 “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14.04.2023 - 20.04.2023, ka filluar shqyrtimin e çështjes duke vlerësuar se ka një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimin administrativ.

Lidhur me këtë denoncim nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk është kërkuar informacion në lidhje me postimet në faqen time të Facebook si Kryetar i Bashkisë Fier dhe të Bashkisë Fier si dhe në vijim të hetimit administrativ nuk jam ftuar si palë në proces për të marr pjesë në seancë dëgjimore.

Në nenin 172/1 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se subjektet elektorale, konkretisht Kryetarët e Bashkive, duhet të kenë marr dijeni se janë kryer shkelje të ndalimeve të përcaktuara në kod dhe të marrin masa për ndërprerjen e shkeljes.

Komisioni ka paragjykuar në vendimmarrje, nuk ka kryer hetim administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike, për të cilat nga pala denoncuese pretendohet se janë kryer shkelje administrative, pa dëgjuar paraprakisht sqarimet, verifikimi i të cilave mund të sillte prova të mjaftueshme për mungesën e shkeljes administrative.

Referuar denoncimit, ju bëj me dije se përsa i përket faqes Facebook Armando Subashi, <https://ëëë.facebook.com/armandosubashi.al>, ajo është një profil i një personi publik, që pavarësisht me pozicionin Kryetar Bashkie, në këto zgjedhje isha një kandidat i një subjekti zgjedhor të rregjistruar në KQZ dhe që ligjërisht humbas të drejtën e kompetencave të plota në institucionin e Bashkisë për të cilën jam një nga kandidatët për drejtimin e saj në 4 vitet e ardhshme, referuar dispozitave të K.Zgjedhor.

Postimet e mia në llogarinë personale në Facebook si Kryetar i Bashkisë nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për propozimin për marrjen e masës administrative, nisur nga fakti se Kryetari i Bashkisë është organ me karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim i arritjeve politike ose çdo lloj platforme tjetër politike për tërheqjen e elektoratit.

Gjithashtu ju bëj me dije se për faqen e Bashkisë Fier në rrjetin social Facebook, jo vetëm përgjatë kësaj fushate por në asnjë moment nuk janë publikuar deklarata, lajme, informacione dhe as janë përdorur simbole që lidhen me politikën apo fushatën zgjedhore. Në faqen zyrtare të Facebook të Bashkisë Fier nuk janë përdorur hashtag/slogane me karakter politik ose elektorale në zgjedhje ose thirrje për mbështetje politike, të cilat do të përbënin përdorim të burimeve publike.

Duke ju referuar objektit të denoncimit, simboli # nuk është përdorur në asnjë moment dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme, pasi ajo është një faqe publike që mund të shihet nga të gjithë. Faqja zyrtare e Bashkisë Fier në rrjetin social Facebook është <https://www.facebook.com/bashkia.efierit>. Edhe në faqen zyrtare Facebook të Bashkisë Fier nuk është pasqyruar asnjëherë asnjë deklaratë, informacion, lajm ose promovim që lidhet me fushatën zgjedhore të Kryetarit të Bashkisë dhe as me politikën.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund t'ju referohet ose të trajtojë marrëdhëniet personale ose postimet personale në Facebook, të cilat dalin jashtë fushës së zbatimit të Kodit Zgjedhor dhe Akteve normative në fuqi, mbi bazën e të cilave është propozuar për dënimin me gjobë.

Propozimi për vendosjen e gjobës të vendosur me vendimin nr. 441 dt. 05.05.2023 i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimi nr. 84 dt. 08.05.2023 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili ka pranuar pjesërisht kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur sanksionin administrativ, gjobë në masën 100 000 lekë për z. Armando Subashi si Kryetar i Bashkisë Fier, duhet të shfuqizohet pasi nuk gjendem në shkëlqje të dispozitave të K.Zgjedhor duke publikuar postime me përmbajtje politike në faqen zyrtare "Facebook" të Kryetarit të Bashkisë. Përsa më sipër, vendimet për gjobitjen time si Kryetar i Bashkisë Fier, janë veprime të kryera në kundërshtim me ligjin dhe rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimet e Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për këto arsye kërkoj shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 84 dt. 08.05.2023 të KAS dhe pushimin e procedimit administrativ në emër të Kryetarit të Bashkisë Fier.

Si prova ju paraqes:

Informacion të Zyrës së Shtypit si dhe faqe të njoftimeve elektronike të adresës zyrtare Facebook të Bashkisë Fier dhe të faqes zyrtare të Facebook të Kryetarit të Bashkisë Fier Armando Subashi".

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT

Sikurse evidentuam edhe më lart, nëpërmjet Vendimit Nr.84 Dt.08.05.2023, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, me ndëshkimin administrativisht të paditësit Armando Subashi në bazë të Nenit 172/1 të Kodit Zgjedhor, i ka bërë njëherësh me dije këtë të fundit, të drejtën e ankimit të vendimit, në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Në këtë kontekst, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve rezulton ta ketë konsideruar paditësin subjekt zgjedhor, bazuar në arsyetimin se:

"5. Për keqpërdorimin e burimeve publike Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi edhe subjektet zgjedhore përfutuese. Kodi Zgjedhor, në pikën 20 të nenit 2 përcakton se "subjekte zgjedhore" janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod". Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetshëm, si dhe për shkak se postimet e aksesueshme në facebook bëjnë fjalë për veprimtari elektorale të tyre dhe jo të subjektit që e mbështet, atëherë për këto shkëlqje duhen trajtuar subjekt zgjedhor përfutues, kandidatët dhe jo partia politike që i mbështet ato.

6. Kandidatët për kryetar bashkie objekt i këtij procedimi administrativ, kanë qenë në dijeni të publikimit të sloganeve politiko-elektorale në faqet zyrtare të rrjeteve sociale të bashkive të tyre. Publikimet në fjalë kanë qartësisht si qëllim sensibilizimin politik të publikut. Në kushtet kur ata gëzojnë cilësinë e subjektit zgjedhor si kandidatë për kryetar bashkie, është e qartë se publikimet në shkelje të ndalimeve në Kodin Zgjedhor, janë kryer në favor të tyre”.

Duke konfirmuar qëndrimin e KAS mbi konsiderimin e paditësit subjekt zgjedhor, Kolegji Zgjedhor Gjqësor, bazuar në të njëjtin arsyetim, vlerëson të qenurit e tij kompetent në shqyrtimin e padisë me objekt vendimmarrjen e KAS.

Kolegji Zgjedhor Gjqësor vëren se, Neni 155/1 i Kodit Zgjedhor, parashikon se:

“1. Në shqyrtimin gjyqësor të kërkesëpadive për të gjitha veprimet procedurale që nuk rregullohen nga ky Kod, Kolegji Zgjedhor zbaton dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e parë”.

Në Nenin 2 të Kodi të Procedurës Civile, i ndryshuar, lidhur me parimet themelore të procesit gjyqësor, parashikohet edhe se:

“Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe”.

Kolegji Zgjedhor Gjqësor, i vënë në lëvizje më datë 15.05.2023 nëpërmjet kërkespadi së paditësit Armando Subashi, planifikoi seancën e parë gjyqësore më datë 18.05.2023, por me pranimin e kërkesës së tij të datës 18.05.2023, për shtyrje seance, vendosi riplanifikimin e saj më datë 24.05.2023.

Paditësi Armando Subashi nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 24.05.2023, megjithë marrjen dijeni rregullisht nëpërmjet Fletëthirrjes Dt.18.05.2023.

Pavarësisht dijeni, paditësi nuk i bëri me dije Kolegjit Zgjedhor Gjqësor, shkaqe që përlligjinin mosparaqitjen e tij në seancën gjyqësore të datës 24.05.2023.

Lidhur me pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve në gjykim, Neni 179 i Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, parashikon se:

“Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten në seancën e parë, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore, dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”.

Kolegji Zgjedhor Gjqësor çmon se ndodhet në rrethanat e parashikuara në dispozitën e sipërcituar.

Shpenzime gjyqësore lidhur me këtë çështje, nuk rezulton të jenë kryer.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Nenin 155/1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në Nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, me shumicë votash:

VENDOSI

- Pushimin e gjykimit të çështjes Nr.20, datë 15.05.2023.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, më datë 24.05.2023.

GJYQTARE	GJYQTARE	GJYQTAR	GJYQTARE	GJYQTARE
Alma Kolgjoka	Manjola Xhaxho	Sokol Ibi	Blerona Hasa	Emona Muçi (Pjesërisht kundër)